VENDIM
Nr. 717, datë 20.11.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I SEGMENTIT TË PARË TË LINJËS 110 kV BALLSH–MARINËZ DHE LINJËS BALLSH–DRENOVË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh–Marinëz dhe linjës Ballsh–Drenovë".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 24 617.22 (njëzet e katër mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë njëzet e dy) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 24 617.22 (njëzet e katër mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë njëzet e dy) lekësh, përballohet nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Zyra Vendore Mallakastër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë së pasurive që shpronësohen sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Zyra Vendore Mallakastër, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSION I SEGMENTIT TË PARË TË LINJËS 110 kV BALLSH–MARINËZ DHE I LINJËS BALLSH–DRENOVË"

Nr. rendor	Nr. shtylle	Pronari			Të dhëna hipotekore						Vlerësimet për shpronësim				Shënime	Adresa
											"Arë"			Vlera totale (lekë)		
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Arë" (m^2)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)			
		A	*B*	*C*	*C*	*Ç*	*D*	*E*	*F*	*G*	*L*	*M*	*N*	*R*	*Y*	*Z*
1	**1**	Barjam	Haki	Barjamaj	Lavdan	2388	530/5	Arë	800	800	83.34	123	10,250.82	10,250.82	Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati Lavdan, Nj. A. Qendër Dukas, Bashkia Mallakastër.
2		Fejzo	Isuf	Çakaj	Lavdan	2388	530/6	Arë	2400	2400	5.0	123	615.00	615.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati Lavdan, Nj. A. Qendër Dukas, Bashkia Mallakastër.
3	**2**	Avdulla	Bakush	Hadaj	Lavdan	2388	110/35	Arë	1225	1225	106.4	123	13,087.20	13,087.20	Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati Lavdan, Nj. A. Qendër Dukas, Bashkia Mallakastër.
4		Axhem	Bakush	Hadaj	Lavdan	2388	110/36	Arë	1520	1520	5.40	123	664.20	664.20	Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati Lavdan, Nj. A. Qendër Dukas, Bashkia Mallakastër.
Vlera totale														**24,617.22**		